

Standardi i bazuar rajonal i profesionit

Formati i standardit me grupet e propozuara të detyrave/funksioneve

Standardi i profesionit: Specialist/e për mekatronikën e kamionëve dhe mjeteve të rënda

Profesioni: Specialist/e për mekatronikën e kamionëve dhe mjeteve të rënda

Spektori: Inxhinieri mekanike (specifik për kodimin kombëtar)

Niveli ISCO: III

Përshkrimi i profesionit:

Specialisti/tja për mekatronikën e kamionëve dhe mjeteve të rënda diagnostikon, mirëmban, kryen shërbime dhe riparimet sistemet mekanike, elektrike, elektronike, hidraulike, pneumatike, pajisje dhe pjesë të tjera të automjetit.

Specialisti/ja për mekatronikën e kamionëve dhe mjeteve të rënda planifikon aktivitete, përgatit burimet e nevojshme dhe hapësirën për kryerjen e punimeve, realizon pranimin e automjetit, përcakton diagnozën duke përdorur metoda, programe/softuerë, pajisje moderne, dokumentacionin teknik, sisteme të informacionit dhe komunikimit etj.. Ai/Ajo kryen procese të kontrollit, mirëmbajtjes, riparimit, zëvendësimit dhe testimit të sistemeve mekanike, hidraulike, pneumatik, elektrike dhe elektronike, të /pajisjeve/pjesëve dhe pajisjeve shitesë në automjet ose, sipas nevojës, i referon këto procese të specialistët përkatës.

Ai/Ajo mban dokumentacionin e punës dhe kryen detyra administrative dhe tregtare të lidhura me fushën e veprimtarisë së tij/saj. Specialisti/ja për mekatronikën e kamionëve dhe mjeteve të rënda komunikon me eprorët, bashkëpunëtorët dhe përdoruesit e shërbimeve (diskuton dhe propozon mundësitë për zgjidhje sipas kërkesave) duke përdorur rregullat e komunikimit etik dhe profesional. Ai/Ajo përdor dhe siguron standardet e cilësisë, zbaton procedurat dhe rregullat për mbrojtjen e shëndetit, sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit, si dhe masat për mbrojtjen nga zjarri.

Gjatë kryerjes së detyrave Ai/Ajo përdor teknologjitë moderne, pajisje/instrumente për matje dhe kontrolle, si dhe mjetet dhe pajisjet e duhura të punës, sipas udhëzimeve të prodhuesit.

Mjedisi dhe kushtet e punës:

Specialisti/ja për mekatronikën e kamionëve dhe mjeteve të rënda kryen detyrat në servis automjeteve ose në terren. Puna kryhet kryesisht në pozicione të ndryshme qëndrimi dhe sipas nevojës në lartësi dhe/ose hapësirë të ngushtë, në hapësira të mbyllura, gjysmë të hapura dhe hapësira të hapura. Puna zakonisht kërkon kujdes 24 orë, punë me turne, si dhe punë në terren me orë të zgjatura pune.

Specialisti/ja për mekatronikën e kamionëve dhe mjeteve të rënda mund të punojë në mënyrë të pavarur, të koordinojë apo mbikëqyr një grup të vogël punëtorësh. Punimet kryhen nën rrezik të shtuar nga lëndimet mekanike, djegiet, rreziku nga rrëzimi, goditjet elektrike, nën ndikimin e rrezatimit elektromagnetik të shtuar, avujve të dëmshëm, pluhurit, zhurmës së lartë, vibrimeve, ndryshimeve të temperaturës dhe stresit psiko-fizik. Për shkak të specifikave të punës dhe rreziqeve ndaj të cilave është i/e ekspozuar specialisti/ja për mekatronikën e kamionëve, i kushtohet vëmendje e veçantë përdorimit të pajisjeve mbrojtëse: këpucë sigurie me mbrojtëse në gishta, doreza mbrojtëse, syze mbrojtëse, mbrojtëse për fytyrën dhe sytë (maskë mbrojtëse).

Punëdhënësi mund të përcaktojë kushte speciale sipas vlerësimit të rrezikut të vendit të punës.

Marrëdhënia me profesione të tjera:

Profesionisti specialist/e për mekatronikën e kamionëve dhe mjeteve të rënda i referohet edhe profileve/certifikatave të tjera në kuadër të të njëjtit sektor: teknik/e i/mekatronikës së automjeteve, mekanik/e e automjeteve dhe elektrikist automjetesh.

Përveç kësaj, specialist/e për mekatronikën e kamionëve dhe mjeteve të rënda mund të bashkëpunojë edhe me sektorë dhe profesione të tjera: teknik në serviset e mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve elektricistë, furnizues të pjesëve rezervë dhe materialeve të tjera, punëtorë në sektorin e ndërtimit dhe transportit.

GRUPI DETYRAVE /FUNKSIONEVE KRYESORE	DETYRAT KRYESORE	AKTIVITETET
1. Analiza, planifikimi dhe organizimi i punës	1.1 Analizon, planifikon dhe organizon aktivitetet e punës	1.1.1. Pranon dhe analizon urdhrin e punës dhe dokumentacionin teknik (dokumentacionin tekniko-teknologjik, manualët dhe udhëzimet për punë dhe mirëmbajtje, listat e kontrollit etj.), në përputhje me kërkesat e detyrës. 1.1.2. Planifikon orarin kohor të realizimit të punimeve në fazë, në përputhje me kërkesat e detyrës, në marrëveshje me eprorët. 1.1.3. Planifikon burimet e nevojshme për realizimin e detyrave në përputhje me dokumentacionin tekniko-teknologjik përkatës (burimet njerëzore, materialet, pajisjet, pjesët rezervë). 1.1.4. Organizon grupet e punëtorëve/specialistëve/kontraktorëve përgjegjës për realizimin e punimeve. 1.1.5. Koordinon aktivitetet e veta me aktivitetet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve të biznesit. 1.1.6. Organizon punën në një mënyrë të qëndrueshme, sipas parimeve të qëndrueshmërisë dhe efikasitetit energjetike.
2. Përgatitja e vendit të punës	2.1. Përgatit burimet dhe vendin e punës për kryerjen e punimeve	2.1.1. Kontrollon kushtet e punës në vendin e punës në përputhje me masat e përgjithshme të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë (ndriçimi, ndotja, burimet e rrezikut fizik, kushtet meteorologjike...) duke marrë parasysh nevojat specifike/individuale të punonjësve. 2.1.2. Përgatit vendin e punës në përputhje me planin ditor të punës dhe prioritetet e punës, sipas udhëzimeve dhe rregulloreve për shëndetin dhe sigurinë në punë. 2.1.3. Përgatit mjetet, mjetet speciale, pajisjet dhe makineritë (vinçat), pajisjet matëse të nevojshme për realizimin e detyrës së punës, në përputhje me dokumentacionin tekniko-teknologjik dhe legjislacionin teknik. 2.1.4. Përgatitet për punë dhe përgatit mjetet dhe pajisjet mbrojtëse. 2.1.5. Mirëmban higjienën e vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve pas përfundimit të detyrës së punës.
3. Detyrat operative	3.1. Pranon kamionë dhe mjete të rënda 3.2. Kryen mirëmbajtje parandaluese në	3.1.1. Merr informacion nga urdhri i punës (tipi i automjetit, regjistrimi, ndërhyrjet e mëparshme, libri i shërbimit – kur është i disponueshëm). 3.1.2. Bisedon me drejtuesin e mjetit për problemet e raportuara dhe shenjat e defekteve. 3.1.3. Kryen inspektimin e jashtëm të automjetit për defekte mekanike, elektrike dhe hidraulike të dukshme. 3.1.4. Kryen diagnozën paraprake të automjetit (lidhja e automjetit me skaner për gabime dhe leximi i gabimeve). 3.1.5. Kontrollon funksionimin e motorit dhe sistemeve kryesore të mjetit gjatë punës në boshllëk dhe, kur është e nevojshme, bën provë në lëvizje të automjetit. 3.1.6. Dokumenton parregullsitë e vëzhguara dhe planifikon aktivitetet e mëtejshme të mirëmbajtjes. 3.1.7. Informon klientin/eprorin për gjetjet fillestare dhe procedurat e mëtejshme. 3.2.1. Kryen kontroll të rregullt të gjendjes teknike të sistemeve në mjetin motorik në përputhje me udhëzimet e prodhuesit, kodet e lexuara dhe procedurat e brendshme të kontrollit.

	kamionë dhe mjete të rënda	3.2.2. Kryen shërbim periodik të sistemeve në mjetet motorike në përputhje me udhëzimet e prodhuesit, kodet e lexuara dhe listat e brendshme të kontrollit (kontrollon/ndërron vajrat, sistemet e furnizimit me gaz të mjetit, lëngun ftohës dhe të frenave, AdBlue, filtrat/pastruesit e ajrit, karburantit, vajit, kabinës, filtrat e gazit...). 3.2.3. Kontrollon dhe zëvendëson sipas nevojës, pjesët e dëmtuara dhe elementët të sistemeve kryesore të mjetit (sistemin e shkarkimit, sistemin e transmetimit të fuqisë, sistemin e drejtimit, sistemin e frenimit, 3.2.4. Kontrollon dhe rregullon gjeometrinë e rrotave sipas nevojës. 3.2.5. Kontrollon dhe regjistron mekanizmin e shpërndarjes së gazrave të motorit (rripat dhe regjistruesit e transmisionit, zinxhirët, ingranazhet, valvulat etj.) dhe vepron në përputhje me udhëzimet e prodhuesit. 3.2.6. Kontrollon dhe zëvendëson, sipas nevojës elementët e sistemeve elektrike dhe telemetrike (bateritë, alternatorin, sensorët e presionit, temperaturës, të kohës dhe rrjedhës së gazit) në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.
	3.3. Kryen inspektim dhe diagnostikim të defekteve në kamionë dhe mjete të rënda	3.3.1. Kryen kontroll vizual dhe akustik të mjetit me qëllim përcaktimin e mosfunksionimeve të elementeve, sistemeve dhe përbërësve të tij, bazuar në informacionet e marra nga klientët ose nga një provë e drejtimit të mjetit. 3.3.2. Kryen operacione diagnostikuese, mat dhe kontrollon parametrat mekanikë të mjetit duke përdorur pajisjet dhe softuerin e përshtatshëm për diagnostikim, si dhe mjetet dhe pajisjet matëse e kontrolluese, në gjendje të ndaluar ose në lëvizje të mjetit. 3.3.3. Teston sistemet elektrike dhe kontrollon funksionalitetin e rrjetit të sensorëve dhe aktuatorëve. 3.3.4. Përcakton vendin, shkallën, llojin e dëmtimeve dhe defekteve të pjesëve dhe elementeve përbërës të sistemeve të mjeteve, në përputhje me dokumentacionin teknik dhe udhëzimet e prodhuesit, bazuar në diagnostikimin e kryer. 3.3.5. Analizon opsionet për riparimin ose zëvendësimin e pjesëve dhe elementëve të dëmtuar të sistemeve të mjeteve ose për kontrolle të mëtejshme (bazuar në rezultatet e diagnostikimit, kriteret e përcaktuara ose udhëzimet e eprorit).
	3.4. Realizon riparime dhe zëvendësime në sisteme të fuqisë motorike të kamionëve dhe mjeteve të rënda	3.4.1. Riparon ose zëvendëson pjesët e motorit dhe të agregateve(sistemi i ushqimit, sistemi i ndezjes/lëshimit të motorit, sistemi i furnizimit me gaz, sistemi i shpërndarjes së gazrave (rripit ose zinxhirit i shpërndarjes...). 3.4.2. Riparon ose zëvendëson elementët e sistemit të transmetimit të fuqisë (volanti, friksioni, kutia e ndërrimit të shpejtësisë,– MT, AT, transmisioni kardanik, transmisioni kryesor, diferencialin, gjysmë boshtet, rrotat lëvizëse). 3.4.3. Riparon sistemin e ftohjes 3.4.4. Riparon ose zëvendëson pjesët e dëmtuara në sistemin e shkarkimit të gazrave dhe filtrin partikular/DP. 3.4.5. Teston fuqinë e motorit me dinamometër, pas riparimit. 3.4.6. Kryen kontrollin përfundimtar dhe provën në lëvizje para dorëzimit të mjetit.
	3.5. Realizon riparime dhe zëvendësime në sistemet hidraulike dhe pneumatike të	3.5.1. Mat presionin dhe rrjedhjen në sisteme. 3.5.2. Identifikon rrjedhjet e mundshme në sisteme. 3.5.3. Teston funksionalitetin e sistemeve hidraulike dhe pneumatike (të ngritjes së ngarkesës, ngritjes së kabinës, frenimi etj.).

	kamionëve dhe mjeteve të rënda	3.5.4. Riparon ose zëvendëson komponentët e dëmtuar hidraulikë dhe pneumatikë (kompresorë, tuba, linja, valvola, rezervuar ajri). 3.5.5. Rregullon valvolat e ventilimit për funksionim optimal. 3.5.6. Zëvendëson guanicionet e dëmtuara ose me defekt.. 3.5.7. Teston sistemet hidraulike dhe pneumatike në tërësi, pas riparimit.
	3.6. Realizon riparime dhe zëvendësime në sistemet elektrike të kamionëve dhe mjeteve të rënda	3.6.1. Kryen matjen e parametrave elektrikë dhe i krahason me standardet dhe normat e përcaktuara në manualët përkatëse. 3.6.2. Lokalizon defektin në sistemet elektrike, paketat elektronike dhe komponentët kompjuterikë. 3.6.3. Kontrollon përputhshmërinë e specifikimeve të pjesës për zëvendësim sipas kodeve dhe tipit të automjetit. 3.6.4. Kryen punime elektrike (çmontim/montim, riparim, zëvendësim, rregullim parametrash – kalibrim...) në sistemin e furnizimit me energji elektrike. 3.6.5. Kryen punime elektrike në sistemin e ndezjes së motorit. 3.6.6. Kryen punime elektrike në sistemin e injektimit të lëndës djegëse 3.6.7. Zëvendëson sensorët (sensorët e presionit të vajit, sensorët e ajrit, sensorët e presionit dhe temperaturës në sistemit të shkarkimit gazeve ...) dhe aktuatorët. 3.6.8. Përditëson dhe kalibron softuerët e CPU-së (njësia qendrore e përpunimit – njësia qendrore për menaxhim) dhe njësitë e kontrollit të sistemeve individuale në mjet 3.6.9. Kryen punime elektrike në automjete elektrike dhe hibride ((çaktivizim/aktivizim, , zëvendësim i baterisë me tension të lartë, rregullatorë të tensionit, motorit elektrik) Teston funksionalitetin e pjesëve të riparuar ose të zëvendësuar.
	3.7. Realizon riparime dhe zëvendësime në sisteme të komfortit dhe të sigurisë aktive dhe pasive, sistemeve sinjalizuese dhe të komfortit të kamionëve dhe mjeteve të rënda	3.7.1. Kontrollon gjendjen fizike të sistemit. 3.7.2. Kryen punime në sistemin e komfortit (sistemin e ngrohjes, ventilimit dhe klimës, ngritësit elektrikë të xhamave, mbylljen qendrore, rregullimin e sediljeve, sistemin multimedial dhe njësitë e kontrollit, ndriçimin e kabinës...). 3.7.3. Kryen punime në sistemin e sigurisë aktive (sistemin ABS kundër bllokimit të frenave, ESP – kontrolli elektronik i stabilitetit, sisteme ndihmëse të frenimit (BA, EBA, BAS), sistemet ndihmëse të drejtimit (ADAS), sistemin e kontrollit të parandalimit të rrëshqitjes (ASR, TCS), kamerat, sensorët e distancës, të kontrolli i shpejtësisë sensorët ndihmës për mbajtjen e korsisë...). 3.7.4. Kryen punime në sistemin e sigurisë pasive (jastëkët e ajrit – AIRBAG, rripat e sigurisë, sistemet e mbrojtjes nga përmbysja, thirrjen automatike në rast aksidenti – eCall). 3.7.5. Kryen punime në sistemin e ndriçimit dhe sigurisë (dritat e ditës, dritat e frenimit, dritat e mjegullës, dritat e ndalimit, treguesit e drejtimit...). 3.7.6. Zbaton testimin e funksionalitetit të pjesëve të riparuar ose të zëvendësuar.

4. Detyrat administrati ve	4.1. Mban dokumentacionin e punës	4.1.1. Plotëson dhe përditëson planin ditor dhe javor të punës në përputhje me formatet e përcaktuara dhe kërkesat e punës. 4.1.2. Mban evidenca të statusit të urdhreve të punës në përputhje me procedurat organizative, rregulloret dhe formatet e përcaktuara. 4.1.3. Plotëson dhe përditëson dokumentacionin përkatës mbi aktivitetet e realizuara në përputhje me detyrat e punës dhe procedurat e organizatës. 4.1.4. Mban evidencën e gjendjes së veglave, pajisjeve dhe aparateve, si dhe masave korrigjuese të nevojshme. 4.1.5. Mban evidencën e stokut, konsumit të materialeve dhe pjesëve rezervë. 4.1.6. Organizon, arkivon dhe ruan dokumentacionin në përputhje me legjislacionin në fuqi, procedurat e brendshme dhe proceset ekzistuese digjitale.
5. Detyrat komerciale	5.1. Realizon blerje të burimeve për punë dhe llogaritje të çmimeve, promovime dhe shitje të shërbimeve	5.1.1. Mbledh informacione mbi disponueshmërinë, çmimet dhe cilësinë e materialeve, pjesëve rezervë, veglave, pajisjeve, aparateve dhe burimeve të tjera të nevojshme për punë në treg. 5.1.2. Përgatit ose merr pjesë në hartimin e ofertave për realizimin e punëve, përgatit specifikimet e materialeve, pjesëve rezervë dhe punimeve, përcakton afatet e realizimit dhe vlerëson kostot. 5.1.3. Bën zgjedhjen, blerjen dhe kontrollin e materialeve të nevojshme, pjesëve rezervë, veglave, pajisjeve, aparateve dhe burimeve të tjera të nevojshme për punë. 5.1.4. Bën llogaritjen e punëve dhe shërbimeve të realizuara, përcakton çmimin dhe përgatit faturat. 5.1.5. Promovon/merr pjesë në promovimin/shitjen e shërbimeve.
6. Komunikimi dhe bashkëpunimi me të tjerët	6.1. Komunikon me bashkëpunëtorët, klientët, institucionet përkatëse dhe pjesëmarrësit e tjerë në procesin e punës	6.1.1. Komunikon me eprorë, kolegë, klientë, institucione kompetente dhe të tjerë, duke zbatuar rregullat e komunikimit verbal dhe jo-verbal. 6.1.2. Krijon dhe mban komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm në mënyrë profesionale dhe etike, duke ndjekur rregullat e komunikimit etik dhe profesional, në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombësinë, fetare, kulture etj., duke përdorur TIK të avancuar. 6.1.3. Punon në grup duke aplikuar siç duhet parimet e punës në ekip. 6.1.4. Përdor teknika motivuese për të krijuar një komunikim të mirë me të tjerët. 6.1.5. U jep udhëzime kolegëve dhe grupit të punës për realizimin e detyrës duke përdorur terminologji të qartë dhe profesionale. 6.1.6. Zgjidh ankesa dhe keqkuptime të brendshme dhe të jashtme duke përdorur teknika të përshtatshme të zgjidhjes së konflikteve. 6.1.7. Informon eprorët për detyrën e përfunduar duke përdorur terminologji të qartë dhe profesionale.
7. Sigurimi i cilësisë	7.1. Zbaton procedurat për sigurimin e cilësisë së punës në	7.1.1. Zbaton rregullat teknike, standardet e cilësisë, procedurat dhe udhëzimet e brendshme në realizimin e detyrave të punës në përputhje me rregullat ligjore.

	përputhje me standardet dhe rregulloret përkatëse	7.1.2. Kryen kontrollin e hyrjes së materialeve, pjesëve rezervë, mjeteve, pajisjeve dhe burimeve të tjera të punës në përputhje me rregullat dhe specifikimet përkatëse. 7.1.3. Përdor pajisjet, mjetet dhe instrumentet e punës në përputhje me udhëzimet e prodhuesit. 7.1.4. Kryen kontrollin e punimeve të kryera sipas fazave dhe kontrollin përfundimtar, në përputhje me urdhrin e punës/udhëzimet e prodhuesit/planin e kontrollit. 7.1.5. Eliminon mangësitë e vërejtura, zgjidh ankesat, për të siguruar cilësinë e punimeve të kryera. 7.1.6. Merr pjesë në kurse/trajnime të rregullta profesionale për përdorimin e standardeve, teknologjive të reja dhe trajnime për zhvillimin e aftësive të transferueshme/mekanike. 7.1.7. Vlerëson punën e tij dhe të kolegëve, duke marrë parasysh natyrën specifike të punës dhe karakteristikat e punonjësve (faza e jetës, aftësitë fizike etj.).
8. Mbrojtja në vendin e punës dhe mbrojtja e mjedisit	8.1. Zbaton procedurat dhe masat e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë	8.1.1. Zbaton rregulloret ligjore dhe ato të brendshme që rregullojnë shëndetin, sigurinë dhe mbrojtjen nga zjarri, si dhe menaxhimin e situatave emergjente. 8.1.2. Përdor pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me standardet dhe udhëzimet përkatëse. 8.1.3. Zbaton masat e mbrojtjes nga goditjet me rrymë gjatë punës me automjete elektrike dhe hibride, në përputhje me procedurat dhe rregulloret ligjore përkatëse. 8.1.4. Kryen kontrollin e rregullt të pajisjeve mbrojtëse personale, mjeteve, pajisjeve dhe burimeve të tjera të punës, në përputhje me standardet dhe udhëzimet përkatëse. 8.1.5. Zbaton udhëzimet përkatëse për përdorimin e agjentëve kimikë të rrezikshëm dhe potencialisht të rrezikshëm, me qëllim ruajtjen e sigurisë dhe shëndetit në punë. 8.1.6. Zbaton planin e evakuimit në rast emergjence, në përputhje me procedurat përkatëse. 8.1.7. Ofron ndihmën e parë në rast aksidenti, në përputhje me procedurat e përshtatshme.
	8.2. Zbaton procedurat dhe masat për mbrojtjen e mjedisit	8.2.1. Mban vendin e punës të pastër dhe të rregullt në përputhje me masat për mbrojtjen e mjedisit. 8.2.2. Klasifikon, ruan apo magazinon materialet dhe dokumentet në përputhje me udhëzimet përkatëse në mënyrë që të mos rrezikojë ndotjen e mjedisit 8.2.3. Organizon/zgjedh, asgjëson, ruan dhe trajton mbeturinat e gjeneruara në procesin e punës në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe procedurat e brendshme të menaxhimit të mbetjeve. 8.2.4. Zbaton masa mbrojtëse kundër ndikimit të çdo gazi, toksinash, avujsh, substancash të ndezshme dhe të rrezikshme 8.2.5. Merr masa në rast të derdhjeve ose rrjedhjeve kimike të çdo reagenti dhe substancave të ndezshme. 8.2.6. Përdor energjinë dhe materialet në mënyrë racionale dhe zbaton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor.